

VENDIM
Nr. 340, datë 5.6.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR
ZHVILLIM TË DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3.5, të vendimit nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 3.6, me këtë përmbajtje:

“3.6. Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2024, do të jetë në masën 495 066 760.71 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 332 281 401,71 (treqind e tridhjetë e dy milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e një presje shtatëdhjetë e një) lekësh pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë;

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i transferohet fondi prej 162 785 359 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku